



BULETINI

Buletini Informativ - Janar - Mars 2023

Mbahet Kuvendi i Punës i FBK-së

Më 22 Mars u mbajt Kuvendi i Punës i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK). Në këtë Kuvend kanë marrë pjesë 31 delegatë nga 40 gjithsej sa numëron Kuvendi. Më pas është miratuar Rendi i Ditës, ku nuk kishte kundërshtime. Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu ka folur për të gjitha pikat e rendit të ditës, e që ishin: Raporti i Aktiviteteve të FBK-së për vitin 2022, Raporti i Auditimit për vitin 2022, Draft Plani i Veprimit 2023, Draft Plani Financiar 2023, Draft Plani i Marketingut 2023 dhe të ndryshme. Kuvendi ka zgjedhur si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, Dren Zatriqin, duke zëvendësuar Artan Spahijën, me kërkesën e këtij të fundit.



FBK do të organizojë edhe një ngjarje madhore, kësaj radhe FIBA 3x3 U23 Nations League

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka fituar të drejtën për të organizuar një tjetër ngjarje madhore. Kësaj radhe FBK do të organizojë FIBA 3x3 U23 Nations League. Kjo është hera e parë që në vendin tonë organizohet një ngjarje e tillë. FBK për herë të parë do të merr pjesë në këtë garë, por edhe do të bëjë organizimin e një "stacioni" të Nations League në vendin tonë në datat 10-12 Korrik 2023.



Kupa e Kosovës në Konakun e Rahovecit

Kupa e Kosovës u zhvillua nga 15 deri më 19 shkurt në Rahovec, në një spektakël të basketbollit. Trepça është fituese e Kupës së Kosovës, duke mbrojtur trofeun e fituar vitin e kaluar. Mitrovicasit në finale mundën Sigal Prishtinën me rezultat 74:66, takimin që u vendos në dhjetë minutat e fundit. Më herët 'Xehetarët' mundën Rahovecin dhe Vëllaznimin. MVP i Final 8 është shpallur Drilon Hajrizi.

Bashkimi fitoi për herë të dytë radhazi Kupën, ku në finale fitoi Prishtinës me rezultat 94:72. Pjesa e parë ishte më e barabartë, por dallimi u bë në pjesën e dytë me prizrenaset që triumfuan dhe festuan në fund. MVP e finales është shpallur Khadija Haywood.

Bora fitoi Kupën e Ligës së Parë te meshkujt.

Skuadra prishtinase në finale mundi New Basket me rezultat 104:62. MVP është shpallur Dion Haxhosaj i Bora-s.



Hidhet shorti për JR NBA Kosova

20 marsi ishte një ditë e rëndësishme për Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK). Me ceremoni zyrtare është bërë hedhja e shortit për Junior NBA Kosova. Ky është edicioni i dytë i kësaj gare, ku marrin pjesë 30 shkolla fillore nga e gjithë Kosova dhe më pas janë ndarë në dy Konferenca dhe gjashtë Divizione. Hapjen e ka bërë Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, i cili ka folur për rëndësinë e këtij projekti. Ish-basketbollisti i njohur i NBA-së, Gordan Giricek dhe ambasadori Erik Brucker kanë folur për rëndësinë e këtij programi. Më pas është hedhur shorti, ku shkollat fillore u ndanë në Divizione përkatëse.

Giricek dhe Brucker stërvitin fëmijët e Kosovës

Ish-basketbollisti i njohur i NBA-së, Gordan Giricek së bashku me Erik Brucker, Menaxher i Lartë për Operacionet e NBA-së më 19 mars kanë mbajtur një stërvitje me fëmijët e Kosovës. Si Giricek ashtu edhe Brucker ishin të lumtur për këtë stërvitje me 15 basketbollistë të rinj, ndërsa në fund u ndan shumë të kënaqur me atë se çfarë kanë parë nga 1 orë e 30 minuta stërvitje. Edhe basketbollistët e rinj kishin mundësi të mësonin shumë, duke marrë parasysh përvojën e Giricek dhe Brucker.



Grumbullohen vashat e Kosovës të udhëhequra nga Shemsije Stublla

Përfaqësuesja e Kosovës U20 te femrat është grumbulluar më 25 mars për herë të parë për ndeshjet të cilat do t'i zhvillojnë në kuadër të FIBA Kampionatit Evropian, Divizioni B, që do të mbahet gjatë datave 28 korrik-6 gusht, në Kraiova të Rumanisë. Vajzat U20 në krye kanë ish-basketbollisten e gjeneratës së artë të KB Universitetit, Shemsije Stublla Tolaj, e cila po ndihmohet nga asistenti i parë slloven Marko Roner si dhe trajneri Qëndrim Demi.



Her World, Her Rules te Kosova U20

Vashat e Kosovës U20 ju kanë bashkuar kampanjës “Her World, Her Rules” (Bota e Saj, Rregullat e Saj” në kuadër të projektit FIBA Europe Girls Program).

Ky program ka për synim masivizimin e basketbollit të femrat dhe mbështetjen për basketbollin femëror, ku Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku së bashku me 23 lojtare dhe stafin e Përfaqësueses së Kosovës kanë përkrahur dhe ju kanë bashkangjitur kësaj kampanje.



Kundërshtarët e Kosovës

Kosova U20 (M): Në Grupin C së bashku me Suedinë, Gjeorgjinë dhe Ukrainën.

Kosova U20 (F): Në Grupin C së bashku me Holandën, Kroacinë dhe Slloveninë.

Kosova U18 (M): Në Grupin C, me Holandën, Estoninë, Ukrainën, Rumaninë dhe Irlandën.

Kosova U18 (F): Në Grupin B, së bashku me Shqipërinë, Moldavinë dhe Armeninë.

Kosova U16 (M): Në Grupin A, së bashku me Andorrën, Moldavinë, Maltën dhe Gjibraltarin.



Caktohen përzgjedhësit e Kosovës

Kosova U20 (M): Përzgjedhës Dritëro Sefaja, ndihmës Dion Pllana.

Kosova U20 (F): Përzgjedhëse Shemsije Stublla, ndihmës Qëndrim Demi.

Kosova U18 (M): Përzgjedhës Brahim Veseli, ndihmësit Endrit Elshani dhe Safet Kastrati.

Kosova U18 (F): Përzgjedhës Furkan Saglik, ndihmësit Emrah Karatas dhe Aurora Muhaxheri.

Kosova U16 (M): Ibrahim Karabegu, ndihmësit Driton Obërtinca dhe Elbasar Gështenja.

Kosova në turneun e YDF-së në Bullgari

Kosova në të dyja konkurrencat me U14 mori pjesën në turneun e YDF-së, që u organizua në Bullgari, nga 29 marsi deri më 2 prill. Kosova në katër ndeshje pësoi katër humbje në të dyja konkurrencat, duke u mundur nga Maqedonia, Veriore, Rumania, Bullgaria dhe Turqia.



Tuhina, kampione e Konferencës PAC-12

Një sukses historik për ekipin e Washington State Cougars dhe basketbollisten nga Astera Tuhina, që është shpallur kampion i Konferencës PAC-12, duke mposhtur UCLA me rezultat 65:61 në Las Vegas. Astera ka luajtur rol kyç në triumfin e ekipit të saj në debutimin e saj në këtë ligë. Tuhina në finale ka luajtur për 31 minuta, duke realizuar gjashtë pikë, gjashtë asistime dhe tri kërcime, duke marrë vlerësime shumë pozitive për paraqitjen në finale, por edhe gjatë gjithë këtij edicioni.



Enisa Kamerolli me suksese në SHBA

Ekipi i basketbollit UT Tyler, ku pjesë është edhe basketbollistja e Kosovës, Enisa Kamerolli, vazhdoi me suksese. UT Tyler u kualifikuan në turneun e parë NCAA DII dhe pasi kanë fituar dy ndeshjet e para, ka mundur Lubbock Christian 67:64 në kohën shtesë për të depërtuar në Elite Tight. Enisa është pjesë e grupmoshave të Kosovës, ndërsa ka luajtur edhe me Kosovën A.



Partizani, kampion i Ligës Unike

Partizani është kampion i Ligës Unike për femrat. Skuadra nga Tirana në finale ka mundur Flamurtarin e Vlorës me rezultat 61:72. Kjo është hera e parë që Partizani fiton Ligën Unike, ndërsa edicionin e kaluar ishte Prishtina. Në Final 4 e zhvilluar në Vlorë më 15 e 16 mars, Partizani në gjysmëfinale kishte mundur Bashkimin, kurse Flamurtari eliminoi Prishtinën. Hanna Brych u shpall MVP e turneut, ndërsa në pesëshen më të mirë të turneut ishin: Sarah Mgbeike e Prishtinës, Aulona Muhadri e Bashkimit, Sophia Jakobsson dhe Samra Omerbasic të Flamurtarit dhe Lasonja Edwards e Partizanit.



Istogu në Superligë



Kosovari në Ligën e Parë



FBK me kampanjë Anti-Doping në basketboll

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka zhvilluar kampanjën anti-doping në basketboll. FBK ka vizituar klubet seniore në të dyja konkurrencat, ndërsa zyrtarët e FBK-së kanë treguar për pasojat që sjell dopingu në sport, përkatësisht në basketboll dhe përgjegjësitë e lojtarëve. Kampanja është mirëpritur nga klubet e basketbollit, duke u njohur nga afër për pasojat që sjell dopingu. Federata e Basketbollit e Kosovës ka marrëveshje me Agjencinë e Anti-Dopingut për Kosovë (KosADA) nga viti 2022. Gjithashtu FBK është përkujdesur që në fillim të këtij viti të shpërndajë listën e WADA-s me substanca dhe metoda të ndaluara 2023 te të gjithë klubet e basketbollit. Gjithashtu FBK ka shpërndarë video dhe informacione në rrjetet sociale gjatë 3 muajve për ndërgjegjësimin e basketbollistëve dhe punëtorëve sportiv rreth dukurive negative të dopingut.



Aktivitetet e FBK-së

Mbahet FIBA Scod Klinika për gjyqtarët

Dushku në Barcelonë për fuqizimin e vajzave dhe grave në basketboll në kuadër të projektit "PROMISE"

Elvira Dushku flet për "Hartimin e Ligjeve të Reja", rëndësinë e procesit të licencimit të Federatave Sportive dhe organizatave sportive nga MKRS

Arben Krasniqi, pjesëmarrës në Punëtorinë e JB NBA Ligës në Paris

Artina Hasani, pjesëmarrëse në shortin për Përfaqësueset e reja të Kosovës

Nadire Kajashi dhe Rrezarta Kqiku, pranohen në Programin e FIBA Europe, WiLead (Women in Leadership 2.0)

Artina Hasani në Programin S2ABC Project - A new training opportunity in Sport Administration

Enea Hajdari pranohet në FIBA Foundation European Youth Leadership Program 2023

Vlora Braha në FIBA Technical Delegate Workshop Cycle 2023-2025

Etna Rexhepi, Merisa Bilalli, Olsa Tahiri dhe Ylza Uka në mesin e Shpresave Olimpikë

Dritëro Sefaja certifikohet në "Programin Ndërkombëtar të Certifikimit të Pasurimit të Trajnerëve (ICECP)"

Driton Obërtinca dhe Valbona Bytyqi pranohen në Programin e Trajnerëve FECC



FALEMINDERIT

SUPPORTED BY:



GENERAL SPONSOR:



TEB

GOLDEN SPONSORS:



SILVER SPONSORS:



YOUTH BASKETBALL SUPPORTERS:



RUGOVE

AUTOMOTIVE SPONSOR:

